




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punës së Kuvendit, si dhe në pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e kuvendit, znj. Adelina Spahiu - Alija:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 29.06.2026, (ditë e Hënë), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë:
REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2027-2029, (Raporton Drejtorit të DBF-së, z. **Behxhet Maliqi**);
5. Raporti vjetor i punës për vitin 2025 i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Eko – Natyra SH.A. Skenderaj, (raporton Aksionari i Ndërmarrjes z. Behxhet Maliqi),
6. Pyetjet e këshilltare nën piken të ndryshme.


KRYSUESJA E KUVENDIT

znj. Adelina Spahiu - Alija





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës **29.05.2026**, ora **10:00**

REND DITE

1. Fjala hyrëse,
2. Miratimi i rendit të ditës,
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
4. Propozim për miratimin e Projekt – Rregullores për Institucionet Edukativo - Arsimore në Komunën e Skenderajt, (raporton Drejtori i DKA-së, z. Kastriot Duraku);
5. Propozim – Vendim për zëvendësimin e anëtares se Komitetit për Komunitete,(raporton Kryesuesja e Kuvendit znj. Adelina Spahiu – Alija);
6. Propozim – Vendim për rishqyrtimin e vendimit për iniciimin e hartimit të PZHK-së i miratuar në seancën e mbajtur me datën; 30.04.2026(Pikë shtesë, raporton Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura),
7. Propozim – Vendim për ngritjen e planit për të hyrat vetanake për vitin 2025 dhe bartja e mjeteve të pa shpenzuar të hyrave vetanake nga viti 2025 për shpenzim në vitin 2026, (Pikë shtesë, raporton drejtori z. Behxhet Maliqi),
8. Propozim – Vendim mbi lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5000€ nga kategoria e subvencioneve në zyrën e Kryetarit për platformën Liria ka Emër, (Pikë shtesë, raporton Nënkryetari i Komunës, z. Fadil Nura),
9. Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Përshëndetje i nderuar Kryetar i Komunës së Skenderajt z. Sami Lushtaku, i nderuari Nënkryetar z. Fadil Nura, te nderuar përfaqësues të OSBE-së, Mapl, anëtar të Kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe ju të gjithë të pranishmit, te pranishëm në sallë i kemi 23 anëtar, mungon me arsye Alban Berisha, mungon pa arsye Hysni Mehani, mungon pa arsye Nezir Bejta, mungon pa arsye Floriana Halili, para se me fillu me rend

dite, për këtë seancë i kemi tri pika të rendit të ditës në mënyrë që me ju shmang thirrjes të një seance të jashtëzakonshme, pasi që rekomandimi prej Ministrisë për rishqyrtim të PZHK -së na ka ardhur pasi që e kemi thirrur seancën si dhe nga financat për ngritje dhe bartje të hyrave vetanake, prandaj kërkoj që këto pika të trajtojmë në këtë seancë, propozimi i parë është Propozim – Vendim për rishqyrtimin e vendimit për iniciimin e hartimit të PZHK-së i miratuar në seancën e mbajtur me datën; 30.04.2026, kush që kjo pikë të hynë në rëndësi, konstatojmë se me 21 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim hynë në rëndësi ky propozim - vendim, vazhdojmë me piken tjetër shtese, Propozim – Vendim për ngritjen e planit për të hyrat vetanake për vitin 2025 dhe bartja e mjeteve të pa shpenzuar të hyrave vetanake nga viti 2025 për shpenzim në vitin 2026, kush është që ky propozim – vendim të hynë në këtë rëndësi, konstatojmë se me 21 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim hynë në rëndësi ky propozim –vendim, vazhdojmë me piken tjetër shtese Propozim – Vendim mbi lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5000€ nga kategoria e subvencioneve në zyrën e Kryetarit për platformën Liria ka Emër, kush është që kjo pikë të hynë në këtë rëndësi, konstatojmë se me 21 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim hynë në rëndësi ky propozim vendim, vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës e hap debatin pasi që nuk ka të paraqitur për diskutim, shkojmë në votim, konstatojmë se me 22 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendi i ditës, vazhdojmë me shqyrtimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap debatin, nuk ka për diskutim shkojmë në votim, konstatojmë se me 21 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar, vazhdojmë me piken e radhës Propozim për miratimin e Projekt – Rregullores për Institucionet Edukativo - Arsimore në Komunën e Skenderajt, (raporton Drejtori i DKA-së, z. Kastriot Duraku);

Kastriot Duraku, DKA - Faleminderit Kryesues, i nderuar Kryetar, të nderuar anëtar të Kuvendit , koleg drejtor, para jush keni rregulloren për Institucionet Edukativo- Arsimore në Komunën e Skenderajt, e cila ka qene në diskutim 17 ditë, gjatë kësaj periudhe komisioni ka pranuar kërkesa sugjerime, ato të cilat kanë qene të arsyeshme e të nevojshme i kemi përfshirë në rregullore, qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë qartë sjelljet dhe obligimet e nxënësve, mësimitdhënësve dhe personelit edukativo arsimor dhe stafit mbështetës konkretisht fokus të veçantë ka qene pjesa masat e nevojshme ndaj sjelljeve jo të mira të nxënësve të nivelit 6 deri 9 veçanërisht masa vetdijesuese, kjo rregullore është hartuar bazuar në legjislacionin në fuqi, rregulloren e MASHT, unë nuk po e zgjati me shumë sepse të gjitha veç i keni në rregullore, mirëpo nëse keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Afrim Kabashi, NSD –Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, se pari ja ua uroj Kurban Bajramin të gjithëve, drejtor e kam lexuar rregulloren, është dokument mjaftë i mirë vetëm uroj të jete i zbatueshëm në praktik, faleminderit.

Kastriot Duraku, DKA – Faleminderit shumë Afrim e ceka se jemi mundë të defekte të rregullores së vjetër të përmirësojmë me këtë rregullore e që shpresoj që do të ndikojë në proces të mësimdhënies.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit drejtor, pasi që nuk ka tjerë për diskutim, shkojmë në votim, konstatojmë se me 22 vota për, 0 kundër 0 abstenim miratohet Propozim për miratimin e Projekt – Rregullores për Institucionet Edukativo - Arsimore në Komunën e Skenderajt, vazhdojmë me piken e 5 të rendit të ditës Propozim – Vendim për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Komunitete,(raporton Kryesuesja e Kuvendit znj. Adelina Spahiu – Alija), propozimi në fjale ka rrjedhë nga kërkesa e komitetit për komunitete për zëvendësimin e anëtares së komitetit Albina Arifi, me Iso Nazufi, e që ju kemi kërkuar që ta bijën anëtares së gjinisë femërore për zëvendësim në mënyrë që ta ruajmë kuotën gjinore mirëpo na kanë thënë se nuk kanë të interesuar të gjinisë femërore të jene pjesë e komitetit, andaj na është dashur ta sjellim kështu në Kuvend, e hap diskutimin pasi që nuk ka për diskutim shkojmë në votim,

konstatohet se me 22 për , 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet propozim – vendimi për zëvendësim të anëtares së komitetit për komunitete, vazhdojmë me piken e radhës Propozim – Vendim për rishqyrtimin e vendimit për iniciimin e hartimit të PZHK-së i miratuar në seancën e mbajtur me datën; 30.04.2026(Pikë shtesë, raporton Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura),

Nënkryetari, z. Fadil Nura – Faleminderit Kryesuesë, përshëndetje për të gjithë, propozimi në fjale ka të bëjë me rishqyrtimin e vendimit për iniciimin e procedurës së hartimit të PZHK-së vendim që na është rekomanduar të shkojmë sipas vendimit të Komunës së Prizrenit, e që ashtu e kemi punuar mirëpo e kanë kthyer për rishqyrtim për disa elemente kryesisht teknike shembull Kline e ulet, kline e poshtme, si dhe tek programi zona urbane e rurale, mirëpo për ta respektuar rekomandimin e Ministrisë e kemi sjellë këtu për ta rishqyrtuar për ti respektuar obligimet ligjore, e kemi përmirësuar me ato rekomandime, andaj kërkoj që ta përkrahni, nëse keni nevojë për sqarime shtese urdhëroni. Faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit nënkryetar, e hap diskutimin.

Afrim Kabashi, NSD – Nënkryetar të nderoj me vëmendje na duhet me kry punën tone ashtu siq e kanë kërkuar ministria duhet ta bëjmë në mënyrë që mos të na u kthehet në vazhdimësi për rishqyrtim, faleminderit.

Nënkryetari, z. Fadil Nura – Ki të drejtë Afrim, ju tregova se na e ka dërgu model ministria ashtu e kemi bërë e kemi përmirësuar tash.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit nënkryetar, pasi që nuk ka tjerë për diskutim, shkojmë në votim, konstatohet se me 21 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim, miratohet Propozim – Vendim për rishqyrtimin e vendimit për iniciimin e hartimit të PZHK-së i miratuar në seancën e mbajtur me datën; 30.04.2026, vazhdojmë me piken e radhës Propozim – Vendim për ngritjen e planit për të hyrat vetanake për vitin 2025 dhe bartja e mjeteve të pa shpenzuar të hyrave vetanake nga viti 2025 për shpenzim në vitin 2026, (Pikë shtesë, raporton drejtori z. Behxhet Maliqi),

Behxhet Maliqi, DF- Faleminderit Kryesuesë, përshëndetje për të gjithë, propozimi në fjale ka të bëjë me ngritjen e planit të hyrave vetanake për vitin 2025 dhe bartjen e mjeteve të pa shpenzuara të hyrave vetanake të vitit 2025 për shpenzim në vitin 2026, ngritja e planit të hyrave vetanake të vitit 2025 është në shumë prej 57,832.21€, si dhe bartja e mjeteve të hyrave vetanake të vitit 2025 në shumë prej 196,275.43€ që në total janë 254,107.64€ e të cilat barten në kategoritë si me poshtë të cilat i raportoj si në material, faleminderit nëse keni pyetje urdhëroni.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit drejtor, e hap diskutimin

Aferdita Pllana – Rama –Faleminderit Kryesuesë, përshëndetje për të gjithë, desha ta ngriti një çështje të cilën e kam drejtuar edhe të drejtoret e mëhershëm tek Rrezarta, Shahini tash të drejtori aktual, për pagesën e një shtese për mjeket që nuk punojnë në ordinancë private , vazhdimisht na është thënë se nuk ka mjete. Kisha kërkuar drejtor me ditë pse nuk po bëhet kjo pagë dhe a keni kërkuar me bërë zgjidhje.

Rrezarta Hasani – Ibrahim PDK- Faleminderit Kryesuesë, po flas për atë kohën sa kam qenë unë duke udhëhequr drejtorin, unë kemi paguar deri në vitin 2024 e mbas vitit 2024 nuk e di më se skam qenë aty, faleminderit.

Behxhet Maliqi, DF- Doktorresh e di këtë çështje, besoj kemi zgjidhur këtë çështje, faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija :Pasi që nuk ka tjerë për diskutim, shkojmë në votim, konstatohet se me 22 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim – Vendim për ngritjen e planit për të hyrat vetanake për vitin 2025 dhe bartja e mjeteve të pa shpenzuar të hyrave vetanake nga viti 2025 për shpenzim në vitin 2026, vazhdojmë me piken e radhës Propozim

– Vendim mbi lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5000€ nga kategoria e subvencioneve në zyrën e Kryetarit për platformën Liria ka Emër, raporton Nënkryetari i Komunës.

Nënkryetari, z. Fadil Nura – Sa i përket këtij propozimi ka rrjedh me kërkesa të platformës Liria ka Emër të cilët planifikojnë të mbajnë konferencë ndërkombëtare e cila është në funksion të historisë sonë të lavdishme andaj ju ftoj që ta miratoni një propozim të tillë që nuk kërkohej shumë e madhe për mbështetje, faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija :Faleminderit Nënkryetar e hapi diskutimin, pasi që nuk ka për diskutim shkojmë në votim të këtij propozim – vendimi, konstatohet se me 22 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim – Vendim mbi lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5000€ nga kategoria e subvencioneve në zyrën e Kryetarit për platformën Liria ka Emër, vazhdojmë me piken e radhës Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

Afrim Kabashi, NSD – Përshëndetje për të gjithë, po i lexoj pyetjet e parashtruara për këtë seance
1.)Per Drejtorin e Drejtorisë e Gjeodezisë dhe Kataster.

Drejtor sa keni informata si drejtorat sa është realizuar në implementimin e projektit të ridentertimit të tokave në komunën tonë gjegjësisht është fjala për projektin në realizim në fsh Polac,Llaushë dhe pjesën e fshatit të ri në hyrje Skenderajit.

2.)Per Drejtorin e Bujqësis dhe Zhvillimit Rural.

Drejtor a keni në planë konkret në përkrahje për sumvencionimin e fermerëve të qumështit në liter,një kërkesë e kahmotshme e fermerëve(prodhuar të qumështit,si dhe duke e pasur parasysh se shumica e komunave në Kosovë tashmë po i sumvencionojnë.

3.)Per Drejtorin për Urbanizim

Drejtor a planifikoni të filloni në punimet e mbetura gjysmë të asfaltimit të disa rrugëve brenda fshatit si tek lagjet Gruda, e Gjamisë,Veliu,Koci të cilat janë të trasuara në zhavorë dhe të cilat janë mbetura të pakryera nga vitet 2023/24.

Granit Musliu, DGJKP – Përshëndetje për të gjithë, faleminderit për pyetjen, lidhur me projektin e rindërtimit kadastral ka qenë projekt mjaftë i rëndësishëm dhe i cili ka përfunduar, dikur rreth 400 land janë trajtuar me atë projekt tash janë në agjension kadastral për tu futur në sistem.

Sabit Ferizi DBZHR- Përshëndetje për të gjithë, këtë vit për shkak të buxhetit të kufizuar nuk kemi mundur të subvencionojmë fermerët për liter qumështi, po besoj që vitin e ardhshëm do të përkrahim, faleminderit.


Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Në mungesë të disa drejtoreve, pyetjet tjera të parashtruara i kalojmë për seancën e radhës, me kaq i mbyllem punimet e kësaj seance, kaloni mirë deri në takimin e radhës.

Proccsmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit





Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

KORNIZA AFATMESME E BUXHETIT 2027-2029

Qershor 2026

Përmbajtja:

Korniza Afatmesme e Buxhetit 2027-2029	1
Hyrje	3
OBJEKTIVAT 2027-2029.....	4
KORNIZA FISKALE E KOMUNËS.....	6
STRATEGJIA ZHVILLIMIT EKONOMIKO LOKAL	7
1. Zhvillimi ekonomik	8
2. Arsimi, kultura, rinia e sporti.....	9
3.Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	9
4. Shërbimet Publike.....	10
TË HYRAT BUXHETORE	11
Parashikimi i shpërndarjes së mjeteve buxhetore në kategori ekonomike për vitin 2027-2029	16
Parashikimi i të hyrave komunale (transferet qeveritare+ të hyrat vetanake)	11
Plani i THV-ve për tri vitet e ardhshme:	15
Buxheti 2027-2029 dhe shpërndarja e tij sipas kategorive ekonomike	
Programi i investimeve publike (PIP).....	16
PERFORMANCA E DREJTORIVE TË KOMUNËS:.....	19
Zyra e Kryetarit.....	19
Kuvendit Komunal.....	20

1.Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore është dokumenti kryesor bazë i buxhetit për vitin 2027 dhe vlerësimet për dy vitet 2028-2029. Në raportet fiskale ndërqeveritare ky dokument pasqyron kufijtë e përgjithshëm të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike dhe programeve për t'i përmbushur objektivat e përcaktuara nga strategjitë zhvillimore komunale.


Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB), që po prezantohet është një dokument i cili azhurnohet dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe të hyrave dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor dhe vlerësimet për dy vitet në vijim. Gjithashtu, KAB siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave objektivat prioritare të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës dhe integrohen në procesin buxhetor.

Hartimi i KAB-it bazohet në :

- Ligjin për financat e pushtetit lokal;
- Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale;
- Ligjin për kufijtë administrativë komunalë;
- Ligjin e buxhetit dhe
- Qarkorja Buxhetore 2027/01 e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
- Në kuadër të avancimit të politikave gjithëpërfshirëse, kjo Kornizë merr në konsideratë edhe parimet dhe kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, duke synuar që planifikimi buxhetor të kontribuojë në mbrojtjen, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve, si pjesë integrale e politikave sociale dhe zhvillimore të komunës.

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve dhe të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2027-2029 gjithnjë duke u bazuar edhe në strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal dhe planin zhvillimor komunal.

Janë tri faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



2.OBJEKTIVAT 2027-2029

Është e qartë tashmë se dokumenti Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) si një version i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), ka të përcaktuara edhe objektivat e saja, qëllim kryesorë ka krijimin e bazës për përgatitjen e buxhetit në këtë rast buxhetin për tri vitet e ardhshme 2027-2029, gjithashtu përkufizon kufijtë e shpenzimeve buxhetore për tri vitet e ardhshme dhe vënë kontekstin e vendosjes së shpenzimeve në sektor të caktuar.

Procesi buxhetor komunal gjatë hartimit të tij merr në konsideratë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve.

Projektet kapitale shumëvjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë.

Objektivat e KAB të Komunës tonë janë:

- Hartimi i një procesi të mirëfilltë buxhetor nga i cili do të rezulton një planifikim buxhetor të qëndrueshëm për vitin 2027 dhe vlerësimet e dy viteve fiskale në vijim,
- Zhvillimi, promovimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës në të gjitha sferat e saja,
- Të sigurohet një planifikim real i shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore,
- Zhvillimi ekonomik, në të gjitha fushat,
- Përmirësimi i ambientit për të jetuar, arritja e standardeve,
- Avancimi i shërbimeve shëndetësore,
- Avancimi i zhvillimit të sistemit arsimor,
- Avancimi i zhvillimit të kulturës dhe sportit,
- Përkrahë dhe ndihmon zhvillimin e biznesit,
- Subvencionimet në bujqësi,
- Mirëmbajtja e hapësirave publike,
- Intensifikimi i kërkesave për përkrahje nga niveli qendror etj.

Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2027-2029

Planifikimi i buxhetit për vitin 2027 mbështetet në Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë 2027-2029 dhe kornizën makro-fiskale për të njëjtën periudhë. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrahë kërkesat e organizatave buxhetore, në përputhje me orientimin sektorial buxhetor dhe prioritetet e përcaktuara në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Objektivat strategjike të Qeverisë janë përcaktuar përmes Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, dhe strategjive sektoriale, si dhe nëpërmjet dokumenteve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian, si Programi për Reforma në Ekonomi 2027-2029 dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Prioritetet e Qeverisë për periudhën trevjeçare të ardhshme përqendrohen në ri-orientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjen e punësimit, dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, që mbrojnë mjedisin dhe sigurojnë ruajtjen e tij për brezat e ardhshëm. Po ashtu, një tjetër prioritet është orientimi drejt transformimit digjital.

Projeksionet fiskale kanë përcaktuar burimet e mundshme të financimit që Qeveria mund të disponojë për shpenzime në vitin 2027, si dhe vlerësimet për vitet 2028-2029. Çdo tejkalim i kufijve të shpenzimeve të përcaktuara në këtë qarkore do të bëjë të detyrueshëm ndryshimin e burimeve të financimit, përfshirë mundësinë e rritjes së burimeve të financimit dhe/ose ndryshimin e politikave tatimore për të siguruar të hyra shtesë.

Projeksionet fiskale kanë përcaktuar burimet e mundshme të financimit që Qeveria mund të disponojë për shpenzime në vitin 2027 në nivel qendror dhe lokal, si dhe vlerësimet për vitet 2028-2029. Çdo tejkalim i kufijve të shpenzimeve të përcaktuara në këtë qarkore do të bëjë të detyrueshëm ndryshimin e burimeve të financimit, përfshirë mundësinë e rritjes së burimeve të financimit dhe/ose ndryshimin e politikave tatimore për të siguruar të hyra shtesë.

Gjatë procesit të hartimit të KAB-it, janë marrë parasysh zotimet tona ndaj obligimeve tona për kontrata afatgjata për investime kapitale dhe mallra e shërbime. Në këtë kontekst, KAB-i 2027-2029 është hartuar në përputhje me obligimet e deritanishme dhe ato në vijim që na presin në planin trevjeçar duke u bazuar në burimet e mundshme të financimit Komunal sipas Qarkores 2027/01.

3.KORNIZA FISKALE E KOMUNËS

Konform përcaktimeve ligjore çdo organizatë buxhetore ka kornizën e saj fiskale mbi bazën e së cilës krijon të hyrat vetanake si njëra ndër burimet e financimit të buxhetit të Komunës. Seksioni mbi kornizën fiskale përbën elementin e parë të procesit që të dërgon në drejtim të përcaktimit të objektivave fiskale të komunës për periudhën e tri viteve të ardhshme.

Pra edhe pse komuna nuk e udhëheq drejtpërdrejt politikën makroekonomike, mjedisi i përgjithshëm ekonomik do të ndikojë në pasqyrën fiskale të komunës dhe si i tillë duhet trajtuar në këtë kornizë. Komponentët e politikës makroekonomike siç janë BPV pastaj inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh komuna në parashikimet e saj fiskale. Në këtë drejtim komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e rishikimit të politikës apo kornizës fiskale të komunës aty ku vlerësohet se ka hapësirë, duke ndërhyrë në rregulloret e brendshme të cilat do të jenë padyshim në funksion të rritjes së efikasitetit dhe të ardhurave të bizneseve, po ashtu rritje të trendit të të hyrave vetanake.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal

<i>Përshkrimi</i>	<i>2026 (aktual)</i>	<i>2027</i>	<i>2028 (vlerësimi)</i>	<i>2029 (vlerësimi)</i>
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	40,664	40,664	40,664	40,664
Numri i bizneseve aktive që janë duke operuar	652	700	730	760
Numri i nxënësve	7,620	7,510	7,250	7,150

Me Qarkoren Buxhetore 2027/01 komuna jonë ka pranuar kufijtë fillestar të financimit për Buxhetin e vitit 2027 si dhe vlerësimet 2028 dhe 2029, në kuadër të cilit ne kemi edhe planifikimin e të hyrave vetanake të bazuar në parametrat fiskal si dhe në përformancën e inkasimit të kërkesave në të gjitha llojet e të hyrave.

4. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIKO-LOKAL

(prioritetet strategjike zhvillimore)

Komuna e Skenderajt ka hartuar dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024-2028, si një projekt tejet i rëndësishëm për projektimin afatmesëm të zhvillimit të komunës tonë. Megjithatë, trajtimi i SZHL-së në përmbajtjen gjenerale të dokumenti të KAB-it është mëse i domosdoshëm. Pra, është e domosdoshme që të veprojë brenda një kornize të përgjithshme (plani strategjik), në të cilën përcaktohen politikat dhe prioritetet afatgjata dhe afatmesme. Korniza Afatmesme Buxhetore shërben si një mjet për të trajtuar prioritetet e konsumit buxhetor të planeve të zhvillimit strategjik, të cilat do të përfshihen në buxhetin e komunës për të realizuar atë gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare 2024-2028.

Një prej çështjeve më të rëndësishme në kuadër të kornizës afatmesme buxhetore është vendosja e prioritetëve zhvillimore, duke pasur parasysh parimin e kontinuitetit në investime kapitale me kornizën buxhetore 2024-2028. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Skenderajt përfshinë një qasje të gjithanshme dhe largëpamëse për të adresuar sfidat dhe mundësitë unike me të cilat ballafaqohet komuna. Duke diversifikuar bazën ekonomike, duke promovuar turizmin, duke angazhuar rininë, duke përmirësuar administratën dhe shërbimet publike dhe avancimin në zhvillimin kulturor dhe sportiv. Strategjia do të zbatohet përmes një sërë projektësh, nismash dhe partneriteteve.

Misioni:

Misioni ynë është që, përmes shërbimeve sa më kualitative maksimalisht dhe në mënyrë sa më efikase, t'i plotësojmë nevojat që presin qytetarët e Skenderajt dhe të gjithë atyre të cilët janë drejtuar komunës së Skenderajt, para së gjithash t'i plotësojmë të gjitha kërkesat ligjore dhe të tjera të gjitha palëve të interesuara.

Vizioni :

Vizioni ynë është që të jemi komuna e cila punon në pikëpamje kualitative të jetës së qytetarëve tanë, zhvillimin e ekonomisë dhe punësimin, sigurinë e qytetarëve, sigurimi i infrastrukturës.

Prioritetet Komunale :

Janë të identifikuar prioritetet e përgjithshme zhvillimore të KAB-it, të cilat burojnë nga Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e që janë:

- Zhvillimi Ekonomik,
- Zhvillimi i Turizmit,
- Angazhimi i të rinjve dhe Zhvillimi i Edukimit dhe Aftësive,
- Bujqësia dhe Zhvillimi Rural
- Kujdesi Shëndetësor dhe Mirëqenies Sociale,
- Zhvillimi i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
- Zhvillimi i Administratës dhe Shërbimet Publike dhe
- Zhvillimi i Infrastrukturës Publike dhe Zhvillimi Urban

a. ZHVILLIMI EKONOMIK

Objektivi parësor i qeverisë tonë lokale mbetet zhvillimi ekonomik, komponentë zhvillimore e cila mundëson arritjen e realizimit të misionit institucional i cili ka të bëjë me ngritjen e mirëqenies qytetare. Komuna ka hartuar dhe ka aprovuar “Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024-2028”, Strategjia e zhvillimit ekonomik për Komunën e Skenderajt fokusohet në rritjen e rrjedhave të të ardhurave, zhvillimin e turizmit, nxitjen e sipërmarrjes dhe inovacionit dhe tërheqjen e investimeve. Këto nisma janë të ndërlidhura dhe krijojnë një qasje gjithëpërfshirëse për arritjen e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në komunë.

Strategjia përfshinë një qasje gjithëpërfshirëse për rritjen e të hyrave komunale, është thelbësore për të përmbushur nevojat buxhetore për operacionet e komunës dhe projektet zhvillimore. Për të adresuar këtë sfidë mund të eksplorohej disa qasje me risi, për gjenerimin e të ardhurave.

Pra dokumenti Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal do të ndihmon dhe lehtëson edhe përcaktimin e prioritetëve zhvillimore si dhe do të jetë bazë e planifikimeve buxhetore për periudhën e vlefshmërisë së tij. Rritja e shërbimeve komunale, zgjerimi i fushës dhe cilësisë së shërbimeve komunale mund të jetë një nxitës i rëndësishëm i të ardhurave. Skenderaj mund të konsiderojë futjen e shërbimeve të reja ose përmirësimin e atyre ekzistuese, si menaxhimi i mbeturinave, parkingjet komunale, apo tarifat e licencimit.

Kapitalizimi i aseteve, rritja e zhvillimit dhe rritjes së infrastrukturës paraqet një mundësi për të kapitalizuar asetet komunale. Komuna mund të marrë në konsideratë dhënien me qira ose në shfrytëzim të pronave të përdorura ose të pashfrytëzuara, të tilla si toka ose ndërtesa, për zhvillim komercial ose rezidencial, Partneritetet Publiko-Private (PPP) mund të jenë një mënyrë strategjike për të nxitur ekspertizën dhe investimet e sektorit privat për të përmirësuar shërbimet publike duke gjeneruar të ardhura për Komunën e Skenderajt.

Trashëgimia e pasur kulturore dhe vendet historike të Komunës së Skenderajt ofrojnë një bazë solide për zhvillimin e turizmit. Megjithatë, sfidat që lidhen me infrastrukturën, marketingun dhe promovimin e turizmit duhet të adresohen për të kapitalizuar plotësisht këtë potencial. Komuna do të punojë ngushtë me investitorët dhe biznese për të ofruar akses të avancuar dhe për të hequr pengesat burokratike. Kjo nënkupton përshtetjen e procesit të lejeve, ofrimin e mbështetjes dhe udhëzimeve për investitorët, madje edhe ofrimin e tokës ose pronave komunale për përdorimin e tyre. Duke krijuar një mjedis mikpritës dhe miqësor për investitorët, Skenderaj mund të tërheqë investime dhe të nxisë rritjen ekonomike.

b. ARSIMI, KULTURA, RINIA E SPORTI

Gjatë periudhës së azhurnimit të kësaj kornize buxhetore, komuna do të vazhdojë në avancimin e mëtejme të kushteve infrastrukturore të sistemit arsimor, e cila padyshim se do të ndikojë drejtpërdrejt në ngritjen e mëtejme të cilësisë dhe sukseseve tjera në këtë sistem.

Viteve të fundit, në sistemin arsimor të Skenderajt është punuar mjaft në fushën e ndërtimit të objekteve të reja shkollore, renovimeve, trajnimit të personelit arsimor, ndërtimin e fushave sportive, instalimin e sistemit të ngrohjeve qendrore në nivel të të gjitha shkollave.

Do të vazhdohen investimet në arsim në këto fusha: funksionalizimi i institucionit të ri parashkollor në qytetin e Skënderajt, adaptimi i objekteve shkollore të pashfrytëzuara në institucione parashkollore, krijimi i qendrave për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, renovimi dhe pajisja me material didaktik- konkretizues për klasët parashkollore, digjitalizimi i shkollave, sigurimi i rrethojave të shkollave, pajisja e shkollave me mjete të teknologjisë informative, kabinete, mjete konkretizimi etj.

Kultura, Rinia dhe Sporti do të vazhdojë të mbetet ndër fokuset kryesore të qeverisë sonë lokale, investimi në këto dikastere ndihmon në ringjalljen ekonomike të qytetit dhe jemi në përpjekje të vazhdueshme që përmes trashëgimisë kulturore siq është projekti madhor ndërtimi i Muzeut dhe Bibliotekës së qytetit, të gjallërojmë jetën e qytetarëve por edhe për të tërhequr turistët dhe investitorët potencial. Fuqia e kulturës përveq shfaqjeve dhe organizimeve do të orientohet në qështjet që lidhen me barazinë gjinore, mjedisin, shëndetin, sfidat në arsim, paqen përmes dialogut ndërkulturor e ndërfaqësor.

Është investuar bukur mirë në infrastrukturën sportive dhe këto investime do të vazhdojnë edhe më tutje, siq është ndërtimi i tribunave të stadionit të qytetit dhe do të vazhdojë mbështetja institucionale përmes subvencionimeve, për të gjithë Klubet Sportive, OJQ-të si dhe Individët në fusha të ndryshme.

c. SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

Sistemi shëndetësor primar në komunën tonë pothuajse në shumë segmente të tij gjatë viteve të fundit është kompletuar dhe se si i tillë tanimë garanton ngritje të përformancës në shërbime shëndetësore për qytetarët tanë.

Vazhdimi i modernizimit të QKMF-së dhe Qendrave Familjare me pajisje mjekësore në të gjitha objektet shëndetësore është i domosdoshëm. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale edhe për këtë periudhë planifikimi është duke rritur aktivitetin e saj edhe në sferën e shërbimeve përmes projekteve siq është programi “Kujdesi shtëpiak për nëna dhe fëmijë”, “Kujdesi paliativ”, “ Vizitat sistematike në shkolla” do të planifikojë gjithashtu ngritjen buxhetore për të avansuar edhe më tej efikasitetin e shërbimeve shëndetësore, pastaj ngritjen buxhetore për ndihmë financiare për personat e prekur nga sëmundje të ndryshme, rastet e dhunës në familje, rastes sociale. Sfidë mbetet furnizimi me barëra dhe material të nevojshëm, kompletimi i vazhdueshëm me pajisje të nevojshme mjekësore, aparaturë laboratorike etj.

d. SHËRBIMET PUBLIKE

Komuna jonë në lëminë e shërbimeve publike qëndron në situatë relativisht të mirë, pasi që gjatë këtyre viteve në fushën e shërbimeve publike janë bërë investime të mëdha, sidomos në lëminë e infrastrukturës rrugore, ndriçimin e qytetit dhe zonave rurale, gjelbërimin e qytetit, shtratin e Lumit Klina që përshkon qytetin, ndërtimi i kanalizimeve edhe në zonat rurale, ujësjellësave dhe investime tjera të nevojshme për komunitetin e komunës tonë. Megjithatë në këtë fushë ka edhe shumë për t'u bërë. Komuna ka bërë edhe një përparim në bashkëpunim me Kompaninë "Uniteti" në drejtim të eliminimit të deponive ilegale. Sfidë do të jetë mirëmbajtja dhe kujdesi ndaj këtyre investimeve të bëra, sidomos mirëmbajtja dhe pastrimi i hapësirave publike gjelbëruese, sheshit, rrugëve, trotuareve etj, shërbime të cilat do të kryhen nga Ndërmarrja Komunale "Eko-Natyrë" SH.A.

Megjithatë, Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029 padyshim se do të përmbajë më shumë investime të cilat do të avancojnë edhe më shumë ngritjen e efikasitetit të shërbimeve publike, si një mision i institucioneve tona.

POLITIKAT E REJA

Politikat e reja të cilat parashikohen të implementohen gjatë kësaj periudhe 2027-2028 duke mos u kufizuar vetëm në këto politika.

Hartimi i KAB-it komunal do të mbështetet në politikat e reja në kujdesin ndaj personave të moshuar të cilat janë inicuar nga qendra e kujdesit ndaj personave të moshuar dhe parsheh shtimin e stafit në këto pozita:

- a) Shtëpiak (një pozitë)
- b) Ndihmes infermier (një pozitë)
- c) Infermier (tri pozita)

Te gjitha këto pozita janë obligative në baze të UA nr. 03/2025 Për Strehimin Rezidencial.

Do të vazhdojnë përpjekjet për integrimin e komunitetit (fshati Banjë me banorë kryesisht serb) në kuadër të arsimit parafillor, me staf prej 8 personave sipas marrëveshjes së Kryetarit të Komunës me përfaqësuesin e Zyrës Komunale për komunitete dhe kthim. Ky komunitet ende nuk është integruar në pajtueshmëri të plotë me sistemin dhe organogramin komunal të qasjes në buxhet duke respektuar LMFPP-në dhe Ligjin e vetëqeverisjes lokale dhe duke dhënë përgjegjësi për raportime financiare (shpenzimi i buxhetit, krijimi i THV-ve sipas rregulloreve komunale).

Në Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:

Edhe në vitin 2027 komuna planifikon që në mënyrë institucionale të përkrahë të gjitha lehonat e komunës nga kategoria e subvencioneve për çdo lindje të fëmijëve si mbështetje për gratë si shtyllë kryesore e familjes dhe shtetit. Sipas të dhënave nga sektori i gjendjes civile komunale mesatarisht numri i lindjeve në vit janë 500 lindje. Kosto e përgjithshme e financimit planifikohet të jetë 100,000.00€.

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MD)Nr.03/2025 për strehimin rezidencial për persona të moshuar. Shtojca nr 3: Standartet minimale të cilësisë për shërbime sociale në strehimin rezidencial për persona të moshuar, planifikojmë rritjen e numrit të stafit në këto pozita:

- a) Shtepiak (një pozitë)
- b) Ndhimes infermier (një pozitë)
- c) Infermier (tri pozita)

Te gjitha këto pozita janë obligative ne baze te UA nr. 03/2025 Për Strehimin Rezidencial

Në sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe të Bujqësisë

Në të dy programet komunale në Bujqësi dhe programin e Zhvillimit Ekonomik do të vazhdojë përkrahja e fermerëve me makineri përcjellëse bujqësore, koshere të bletëve, serra, pemë dhe perime etj.

TË HYRAT BUXHETORE

Parashikimi i të Hyrave Komunale (Transferet Qeveritare, të Hyrat Vetanake)

Në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2027 dhe orientimet për vitet 2028-2029, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2027 si dhe parashikimin afatmesëm 2028-2029.

Kurse parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2027, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën nr.1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Burimet e Financimit Komunal për vitin 2027-2029

Granti i Përgjithshëm ¹

Korniza Afatmesme Buxhetore përmban analizën me përmbajtje mbi segmentin e parashikimit të të hyrave buxhetore prej të dy burimeve të financimit por me fokus të hyrave vetanake pasi që totalët e granteve qeveritare janë të përcaktuara sipas formulës qeveritare të zbatuar nga Komisioni i Granteve. Ashtu siç theksuam edhe më lartë Qarkorja Buxhetore 2026/01, karakterizohet me zbatimin e rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2024, kriterëve për shpërndarjen e Grantit të Përgjithshëm si dhe kriterëve për Grantin Specifik për Arsim e Shëndetësi të cilët mbështetën në qasjen me sistem të hapur sipas LFPL të financimit.

Bazuar në të dhënat nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2027 është aprovuar në shumën prej 385 milion euro.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përfshirë: mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2027 është në shumë prej 385.02 milion euro. Të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2025 pritet të jenë 3,871.6 milion euro.

Tabela 1: Përcaktimi i vlerës së Grantit të Përgjithshëm për komuna 2026-2028 (mil. Euro)

Përshkrimi	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë	2,985.32	3,227.19	3,544.30	3871.61	4154.02	4476.35
- Fermerët e komunës do të trajtohen përmes Ministrisë së Bujqësisë dhe ZHR-së në mbjelljen e grurit, misrit, subvencionimi i mbajtjes së lopëve , deleve shtimin e numrit të shoqërive të bletëve si dhe sigurimin e granteve për mekanizëm të nevojshëm bujqësor. Gjithashtu drejtorja planifikon të vazhdojë me këshillime te ndryshme nga MBPZHR dhe zyra e këshillimeve .

▪ **Objektivat e Performancës**

Matjet Kryesore të Përformancës	2027	2028	2029
Trajtimi i fermerëve nga fondi për zhvillim e bujqësisë	220	235	250
Kërkesat e vlerësuara të fermerëve për aplikim në AZHRB	35	310	330
Subvencionimi i bujqëve nga fondi komunal për Subvencione	100	200	350
Bashkëpunimi me donatorë dhe organizata	750	600	800

10. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Misioni

Misioni i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) zhvillimi i aktiviteteve kulturore-sportive dhe angazhimi i rinisë në këto aktivitete, shënimin e datave historike dhe kremtimin e tyre. Organizon festivale, koncerte festive dhe humanitare , Gjithashtu, DKRS organizon mbajtjen e tubimeve përkujtimore, promovimin e librave, promovimin e kreativitetit në arte muze, arkivi dhe trashëgimisë kulturore dhe shumë aktiviteteve tjera që zhvillohen në kuadër të komunës.

Drejtoria funksionon përmes këtyre sektorëve:

1. Sektori i Kulturës
2. Sektori i Rinisë
3. Sektori i Sportit dhe
4. Sektori i Bibliotekës

Prioritetet:

- Avancimi i jetës kulturore, rinore dhe sportive.
- Përmirësimi i infrastrukturës kulturore dhe sportive.
- Përkrahja e aktiviteteve të organizatave rinore joqeveritare dhe krijimi i hapësirave vepruese.
- Organizimi i garave të ndryshme sportive;
- Menaxhimi i hapësirave publike kulturore dhe sportive;
- Kujdesi për trashëgiminë kulturore, arkiv dhe muzeun komunal
- Subvencionimin e të gjitha klubeve publike në sportet përkatëse

Punën e vet Drejtoria do ta orientojë në:

- a) Udhëheqjen në mënyrë të drejtë me teatër, bibliotekë, arkiv, muze, stadiumin e qytetit, palestrën e sporteve në përputhshmëri me ligjet dhe aktet normative në fuqi
- b) Kujdesin për formacione të tjera nga Kultura, Rinia, e Sporti që nuk kanë hapësirë e kushte punë;
- c) Organizimin dhe shënimin e datave me rëndësi historike kur kërkohet;
- d) Organizimin e debateve për zhvillim dhe avancim të kulturës dhe trashëgimisë kulturore
- e) Gjetjen e mundësive për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- f) Grumbullimin e shënimeve faktike për të arriturat në Kulturë, Rini, Sport e Bibliotekë
- g. Bashkëpunim të ngushtë dhe raportimi për punën e vet: Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini, Fe dhe Sport, kurdo që kërkohet;
- h. Bashkëpunim me Drejtoritë komunale dhe në nivel qendror nga fushë veprimtaria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të këmbëjë përvoja, si dhe me OJQ-të e organizata tjera; Bashkëpunim me MKRS, KOK , Federatat sportive dhe federaten e sportit shkollor, dhe Federatat vendore dhe ndërkombëtare sportive.
- i. Respektimin dhe përkrahjen e asociacioneve, klubeve, shoqatave dhe krijimin e individëve me aftësi të posaçme kreative pa bërë ndonjë dallim, racor, gjinor apo fetar;
- j. Ofrimin e institucioneve të veta në shërbim të përgjithshëm të qytetarëve (me veprimtaritë primare që kryejnë ato, por në raste emergjente dhe veprimtari të tjera);
- k. Joshjen e investitorëve, kërkimin e fondeve shtesë;
- l. Organizimin e debateve për avancim dhe zhvillim të sportit;
- m. Organizimin e anketave, seminareve e trajnimeve për kyçe të rinjve në aktualitetet rinore, evropiane e botërore;
- n. Regjistrimin e grupeve, klubeve, kuvendeve etj.

Për të realizuar misionin e vet, Drejtoria planifikon të realizojë këto objektiva:

- Ruajtja e stabilitetit buxhetor përmes politikave të kontrollit të brendshëm.
- Shfrytëzimi racional i hapësirave kulturore dhe sportive duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë.
- Rritja e përkrahjes për grupet dhe individët që tregojnë sukses në fushën e artit, kulturës dhe sportit.
- Rritja e kujdesit për trashëgiminë kulturore

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

Kulturë, Rini dhe Sport

	Kateg. e shpenzimeve ekonomike	VITET		
		2027	2028	2029
		Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €
1	Pagat dhe Mëditjet	188,801.00	189,744.90	190,694.00
2	Mallrat dhe Shërbimet	79,830.00	79,380	82,380
3	Shërbimet Komunale	0.0		
4	Subvencionet	150,000.00	150,000.00	160,000.00
5	Investimet Kapitale	0.0		
	Gjithsej:	418,181.00	419,124.92	433,073.65

<i>Numri i të punësuarve</i>	21	21	21
------------------------------	----	----	----

Objektivat e performancës

Nr	Përmbajtja e aktivitetit	Sektori	Afati
1.	Dita e Pavarësisë së Kosovës.	K.R.S	17 Shkurt
2.	Beteja e Likoshanit dhe Çirezit. Akademi dhe aktivitete tj.	Kulturë	28 Shkurt
3.	Java kulturo-sportive "Epopeja e UÇK-së"	K.R.S	1-7 Mars
4.	Turniri Memorial "Ilir Lushtaku" në futboll të vogël	Sport	26 Mars
5.	28 Mars- Dita e përkujtimit të Martirëve të Skenderajt	K.R.S	26,27 dhe 28 Mars
6.	Liga komunale në futboll të vogël	Sport	Gjatë tërë vitit
7.	Turniri memorial në futboll të vogël "Ilaz Kodra"	Sport	Prill
8.	Aktivitet për maturantët	Rini	Maj
9.	Java e dhurimit të librit	Kulturë, biblioteka	Maj
10.	Festivali i Teatrove shkollore dhe për fëmijë	Kulturë	3,4,5 Qershor
11.	Kolonia e Artistëve të artit figurativ	Kulturë, Rini	15,16,17 qershor
12.	Dita e Çlirimit të Skenderajt dhe përkujtimit të dëshmorëve	K.R.S	18 Qershor
13.	Java e Diasporës	K.R.S	Korrik
14.	Muaji rinor	K.R.S	Shtator
15.	Aktivitetet rinore për shënimin e datave ndërkombëtare	Rini	Gjatë gjithë vitit
16.	Mbështetja e Qendrës Rinore Publike	Rini	Gjatë gjithë vitit
17.	28 Nëntori & Fest. Folk "Rapsodia Shqiptare"	K.R.S	26,27 dhe 28
18.	Mbështetja financiare për Ansamblin "Drenica"	Kulturë	Mars – Qershor
18.	Aktivitetet Kulturore (Muzeu, Arkivi dhe Teatri).	Kulturë	Gjatë vitit
19.	Përzgjedhja e më të mirëve në fushën e kulturës dhe sportit	K.R.S	Dhjetor
20.	Aktivitetet tjera kulturore: Promovime librash, ekspozita, etj.	Kult.Biblio.	Gjatë tërë vitit
21.	Pritja e Vitit të Ri	Rini	Dhjetor
22.	Organizimi i debateve dhe tryezave të ndryshme me të rinjtë	Rini	Gjatë gjithë vitit
23.	Mbështetja e klubeve sportive	Sport	Gjatë gjithë vitit

11. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK NDËRMARRËSI INOVACION DHE TURIZËM

Misioni

Të Përmirësojë ambientin për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Të implementojë strategjitë për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2024-2028. Drejtoria synon të themelojë “partneritet” me komunitetin e bizneseve dhe e sheh rolin e saj si promovues të përmirësimit të infrastrukturës si bazë për zhvillim ekonomik. Drejtoria, gjithashtu ka për qëllim thjeshtësimin e rregulloreve dhe procedurave komunale që kanë të bëjnë me veprimtarin e bizneseve në Komunë

Zyra e zhvillimit ekonomik:

Zyra e Zhvillimit Ekonomik përqendrohet në përmirësimin e ekonomisë në Skenderaj përmes: 1) ruajtjen dhe rritjen e bizneseve që aktualisht operojnë/veprojnë në Skenderaj, 2) inkurajimi i fillimit të bizneseve nga banorët e Komunes , inkurajimi i bizneseve të reja të vendosen në Skenderaj. Planifikon dhe punon me zyrat tjera komunale për të bërë planifikimin për projektet dhe për identifikimin e nevojave në infrastrukturë në fshatra dhe qytet. Sektori për planifikim mirëmban një listë për projektet prioritare, në baza dy-vjeqare.

Njësia për biznese dhe investime

Funksionalizimi i tërësishëm i ofrimit të shërbimeve ndaj bizneseve, heqja e burokracisë dhe Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme përcjellëse për investitorë.

Ofrohen dhe shërbimet për biznese si

Regjistrimi i bizneseve të reja;

-Ndryshime të tjera në biznese;

-Ç’regjistrimi i bizneseve;

-Ndërrim i Certifikatave;

-Vërtetime;

-Informata;

Njësia për Turizëm

Përmirësimi i mekanizmave ekzistues dhe krijimi i mekanizmave të rinj institucional për bashkëpunim me shoqërinë civile; ambientalistët dhe ekspertët në fushat e zhvillimit të turizmit; Hulumtimi, planifikimi, hartimi i projekteve për donatorë të ndryshëm për mbështetje të projekteve në fushën e turizmit; Promovon turizmin duke shfrytëzuar hapësirat që ofron teknologjia bashkëkohore dhe forma të tjera; publikon informacione për turizmin në Skenderaj dhe realizon projekte në fushën e turizmit.

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

**Zhvillimi ekonomik,
Ndërmarrësi, Inovacion**

	Kateg. e shpenzimeve ekonomike	VITET		
		2027	2028	2029
		Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €
1	Pagat dhe Mëditjet	93,832	94,301.40	94,773.00
2	Mallrat dhe Shërbimet	51,000.00	51,000.00	61,000.00
3	Shërbimet Komunale	0.00		
4	Subvencionet	140,000.00	160,000.00	170,000.00
5	Investimet Kapitale	165,000.00	170,000.00	170,000.00
	Gjithsej:	449,832.00	475,301.36	495,772.87

Burimet e pozitive	10	10	10
--------------------	----	----	----

Matjet kryesore të përformances

Programi: burimet financiare	2027	2028	2029
Administrata	2500	3000	3500
Zyra për zhvillim e komunikim			
Regjistrimin e bizneseve të reja	180	190	200
Trajnime për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të hapin biznes	20	30	30
Mbajtja e panairove	2	2	2
Mbajtja e garës për ide inovative	1	1	1
Zyra për planifikim ekonomik			
Ndarja e granteve për Start-up	-	-	-
Participimi tek NVM që dëshirojnë me hap degë të re prodhuese	-	-	-
Krijimi i Qendrës për trajnime			
Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për zhvillim ekonomik			
Sinjalizimi i pikave turisike			

12. DREJTORIA PËR ARSIM

Misioni

Misioni i Drejtorisë për Arsim është ngritja e cilësisë, menaxhimi dhe koordinimi i arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm si dhe përgjegjësia dhe transparenca në punë.

Drejtoria Komunale e Arsimit funksionon sipas këtyre sektorëve:

- 1.Sektori i administratës
- 2.Sektori për buxhet dhe financa
- 3.Sektori i Arsimit i ndarë sipas niveleve:
 - niveli parashkollor dhe fillor(0-1)
 - niveli i mesëm i ulët (2)
 - niveli i mesëm i lartë (3)
- 4.Sektori i shërbimeve teknike

Punën e vet drejtoria do ta orientojë :

- në menaxhimin dhe drejtimin efikas të punëve brenda drejtorisë,
- regjistrimin dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve në bankat shkollore,
- krijimin e kushteve të favorshme për punë në të gjitha institucionet shkollore,
- menaxhimi dhe koordinimi i arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunë,
- pajisja e shkollave me mjete të nevojshme didaktike ,
- përfshirja në aftësimin profesional të mësimitdhënësve, stafit profesional dhe drejtorëve të shkollave,
- ngritja e infrastrukturës shkollore - ndërtimit të objekteve të reja shkollore në këtë vit shkollor ndërtimi i dy objekteve shkollore investim i ministrisë së arsimit,
- renovimet dhe përgatitjet higjeno-teknike të shkollave,
- planifikimi dhe sigurimi i bursave për studentët e komunës brenda mundësive buxhetore.
- planifikimi dhe sigurimi i bursave brenda mundësive buxhetore për nxënësit me gjendje të rëndë ekonomike .

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar
ARSIM DHE SHKENCË

	Kateg. e shpenzimeve ekonomike	VITET		
		2027	2028	2029
		Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €
1	Pagat dhe Mëditjet	7,678,238.00	7,716,629.50	7,755,213.00
2	Mallrat dhe Shërbimet	872,000.00	872,000.00	1,004,088.00
3	Shërbimet Komunale	73,800.00	73,800.00	73,800.00
4	Subvencionet	120,000.00	120,000.00	120,000.00
5	Investimet Kapitale	65,000.00	120,000.00	165,000.00
	Gjithsej:	8,809.038.00	8,902,429.09	9,118,100.24

<i>Numri i të punësuarve</i>	<i>870</i>	<i>870</i>	<i>870</i>
------------------------------	------------	------------	------------

<i>Matjet Kryesore të Performancës</i>	<i>2027</i>	<i>2028</i>	<i>2029</i>
Vizita në shkolla	400	400	400
Organizimi i Testit Shtetëror të Maturës	2	2	2
Organizimi i Testit të Arritshmërisë	1	1	1
Vlerësimet e brendshme	100	100	100
Organizimi i garave në nivel shkolle, komune, rajoni dhe republike	45	45	45
Mbajtja dhe organizimi i Ditëve të Shkollave	27	27	27
Vizita dhe kontrolla të administratës së shkollave	100	100	100
Vizita për renovime dhe mbikëqyrje të shkollave	130	130	130
Regjistrimi i inventarit në shkolla	1	1	1
Shpallja e konkurseve të rregullta dhe të jashtëzakonshme	6	6	6
Rrjedha e parasë	1	1	1
Deklarimi i faturave të papaguara	12	12	12
Zotimi i mjeteve buxhetore	12	12	12
Shpenzimi i mjeteve buxhetore	12	12	12
Takimet e rregullta me drejtorë shkollash, me zyrtarë të rajonit dhe të MASHT	12+6+12	12+6+12	12+6+12
Aktivitete sportive, kulturore	9	9	9
Aktivitete profesionale	3	3	3

13. DREJTORISË PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Misioni

DSHMS-ja ka për mision të vetin të sigurojë, përforcojë dhe ofrojë qasje në shërbime cilësore të kujdesit primar shëndetësor, staf mjekësor të shkathët dhe programe inovative si dhe të zhvillojë sistemin e ofrimit të mbrojtjes parësore shëndetësore sa më cilësore, duke u bazuar në nevojat e popullatës në tërë territorin e komunës si dhe përkujdesjen sociale për të gjithë banorët, veçmas të atyre me status të rëndësishëm social, në kuadër të mundësive të saja . Funksionin e sajë e kryen përmes Kujdesit Primar Shëndetësor QKMF, Qendrës për Punë Sociale QPS, Shtëpisë së Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare SHPMPPF dhe Administratës.

Objektivat e drejtorisë

- Përmirësimi i menaxhimit në drejtim të caktimit të qartë të prioriteteve në lidhje me kujdesin shëndetësor si dhe involvimin e partnerëve në çështjet ku është e nevojshme një çasje gjithëpërfshirëse;
- Vendosja e një agjende të saktë në lidhje me aktivitetet, çasje stimulative në aplikimin e njohurive ekzistuese si dhe ofrimin e mundësisë për zgjerim të njohurive dhe shkathhtësisë për stafin, përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional;
- Vendosja e normave dhe standardeve si dhe promovimi dhe monitorimi i implemetimit të tyre duke pas parasysh mjekësinë e bazuar në të dhëna bashkëkohore dhe artikullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me etikën profesionale;
- Ofrimi i mbështetjes teknike, inicimin e ndryshimeve dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale të qëndrueshëm;
- Monitorimi i gjendjes shëndetësore si dhe vlerësimin e trendeve shëndetësore në komunë.
- Përkrahja e aktiviteteve sociale përmes involvimit më të madh të QPS dhe SHPMPPF (Shtëpisë së Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare) dhe partnerëve tjerë qeveritar dhe joqeveritar në rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale në komunë;
- Tani edhe me funksionalizimin e objektit të ri të QKMF-së do të ofrojmë një standardizim të infrastrukturës moderne në kuadër të shërbimeve shëndetësore, ku do të mundësojmë efikasitet dhe shërbime më të shpejta më cilësorë dhe më bashkëkohore për qytetarët.

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

Drejtoria e Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale:

	Kateg. e shpenzimeve ekonomike	VITET		
		2027	2028	2029
		Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €
1	Pagat dhe Mëditjet	2,237,614.00	2,248,302.00	2,259,043.00
2	Mallrat dhe Shërbimet	795,530.00	810,530.00	999,030.00
3	Shërbimet Komunale	82,900.00	82,900.00	82,900.00
4	Subvencionet	130,000.00	142,000.00	150,000.00
5	Investimet Kapitale	61,000.00	65,000.00	95,000.00
	Gjithsej:	3,311,044.00	3,348,732.00	3,585,973.00

<i>Numri i të punësuarve</i>	248	248	248
------------------------------	-----	-----	-----

1. Objektivat e Performancës

<i>Matjet Kryesore të Përformancës</i>	2027	2028	2029
Vizita mjekësore	200.000	210.000	215.000
Shërbime përcjellëse shëndetësore (injeksione, infuzione, inhalime, pastrim dhe përpunim plagësh, EKG etj)	300000	355000	260000
Vizita mjekësore shtëpiake	1000	1100	1200
Vizita stomatologjike	12000	15000	20000
Vizita konsultative – specialistike (pediatri, radiologji, puimologji, mjekësi pune)	40000	45000	50000
Shërbime stomatologjike	200000	220000	25000
Shërbime laboratorike (analiza biokimike, hematologjie dhe bakteriologjike)	90000	95000	100000
Shërbime në rëntgen dhe ultrazëri	8000	8500	9000
Vaksinimi i fëmijëve në terren	20000	1900	1850
Edukimi i vazhdueshëm profesional (mjekë dhe tek.)	50	50	50
Edukimi shëndetësor i popullatës në terren(13 QF x 2)	45	50	55
Bartja e pacientëve në QKU për trajtim të mëtejshëm)	2000	1800	1700
Bartja e pacientëve për dializë(10.000 km) trajtimi tri herë në javë	19	20	22

14. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Deklarata e misionit

- Që të zhvillojë dhe të sigurojë me efektivitet dhe efikasitet:
- Kushtet higjieniko-sanitare dhe teknike në ambientet ku qytetarët e Skenderajt jetojnë, punojnë, edukohen, shërohen, argëtohen, etj.
- Normat dhe standardet e operatorëve që kryejnë veprimtari ligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie,
- Implementimin e masave dhe programeve preventive përmes zhvillimit dhe forcimit të inspektimeve kompetente ligjore.

Deklarata e Vizionit : Vizioni i DI-së është mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e shëndetit publik, mbikqyrja dhe aplikimi i ligjeve për planin zhvillimor, rregullativ dhe urbanistik, përmes inspektimeve, vendimeve, pëlqimeve, evidentimeve dhe ndërmarrjen e masave ligjore ndaj subjekteve – operatorëve që kryejnë veprimtari joligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie duke siguruar kushte dhe ambient të shëndoshë për qytetarët e komunës.

Deklarata e Qëllimit : Mbikqyrja dhe aplikimi i ligjeve dhe akteve tjera ligjore në fushën e ndërtimit, mbrojtjes së ambientit, trafikut urban - komunikacionit, rrugëve etj.

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

Inspektimet

	Kateg. e shpenzimeve ekonomike	VITET		
		2027	2028	2029
		Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €
1	Pagat dhe Mëditjet	101,635.00	102,143.60	102,654.00
2	Mallrat dhe Shërbimet	125,000.00	125,000.00	125,000.00
3	Shërbimet Komunale	0.0 -		
4	Subvencionet	0.0 -		
5	Investimet Kapitale	0.0 -		
	Gjithsej:	226,635.00	227,143.56	227,654.27

Burimet e pozitave	10	10	10
--------------------	----	----	----

KOMUNA:		VITET		
	Kateg. e shp. ekonomike	2027	2028	2029
		Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €
1	Pagat dhe Mëditjet	12,252,605.00	12,313,368.40	12,374,435.00
2	Mallrat dhe Shërbimet	3,306,675.00	3,321,675.00	3,718,313.00
3	Shërbimet Komunale	326,700.00	326,700.00	326,700.00
4	Subvencionet	1,010,000.00	1,067,000.00	1,185,000.00
5	Investimet Kapitale	3,918,810.00	4,568,717.00	5,177,651.00
	Gjithsej:	20,814,790.00	21,597,460.00	22,782,099

<i>Vitet:</i>	2027	2028	2029
Pozitat e kërkuara	1,373	1,373	1,373

Skenderaj,
Datë 12.06.2026



Kryetari i Komunës
z. Sami Lushtaku

15. DREJTORIA E PROKURIMIT

Misioni

Drejtoria e Prokurimit siguron që proceset e prokurimit të jenë të efektshme transparente dhe të përgjegjshme duke ofruar vlerë maksimale për organizatën dhe duke mbështetur objektivat strategjike që i referohet procesit në të cilin autoritetet kontraktore blejnë mallra, punë ose shërbime nga operatorët ekonomikë është garantimi i zbatimit të rregullave të legjislacionit në fushën e prokurimit publik. Në këto kushte, prioritet mbetet respektimi i parimeve të tilla si mos diskriminimi, trajtimi i barabartë, mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive, rritja e transparencës etj, të ndërlidhura me luftën kundër korrupsionit, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit dhe konsumatorit, etj.

Drejtoria funksionon përmes një sektori të vetëm siç ishte edhe para themelimit të saj i tërë stafi pavarësisht punëve voluminoze mbetet i njëjtë.

PUNËT E DREJTORISË SË PROKURIMIT PUBLIK DO TË ORIENTOHEM NË :

1. Planifikimi preliminar , përfundimtar , indikativ dhe Strategjia e prokurimit
2. Përgatitja e procedurave të prokurimit (furnizime , shërbime , kapitale etj.)
3. Planifikim i buxhetit –analiza e nevojave
4. Përgatitjen e përgjigjeve ndaj kërkesave për rishqyrtim dhe Ankesave nga OE
5. Përgatitja e raporteve të rregullta sipas LPP-së
6. Raportimin e rregullt në KRPP, ZKA
7. Krijimin e politikave të favorshme në fushën e prokurimit
8. Krijimin e kushteve të favorshme për konkurrencë të mirëfilltë
9. Efikasiteti dhe Transparenca: Përmirëson menaxhimin financiar dhe rrit transparencën në proceset e prokurimit

Kjo qasje jo vetëm që ndihmon në përdorimin efikas të burimeve, por gjithashtu forcon kapacitetet institucionale për menaxhimin e prokurimit dhe përmirësimin e rezultateve financiare dhe operacionale.

DREJTORIA E PROKURIMIT		VITET		
	Kateg. e shpenzimeve Ekonomike	2027	2028	2029
		Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €
1	Pagat dhe Mëditjet	60,845.00	61,149.60	61,455.00
2	Mallrat dhe Shërbimet	19,000.00	19,000.00	19,000.00
3	Shërbimet Komunale			
4	Subvencionet	-	-	-
5	Investimet Kapitale	-	-	-
	Gjithsej:	79,485.00	80,149.63	80,455.38

Numri i të punësuarve	6	6	6
-----------------------	---	---	---



Komuna Skënderaj

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 02-052/01-0022743/26
No. 02-052/01-0022743/26
Data. 19.06.2026
Data. 19.06.2026



N.P.L. "Eko Natyra" Sh. A. - Skenderaj

**KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE I N.P.L "EKO NATYRA" SH. A NË
SKENDERAJ**

**RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KOMISIONIT KOMUNAL TË
AKSIONARËVE PËR VITIN 2025**


**Kryesues i Komisionit
Komunal të Aksionarëve**

Skenderaj, 2026



Përmbajtja

Hyrje.....	3
1. EMËRIMI DHE PUNA E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE.....	4
1.1 PUNA E BORDIT TË DREJTORËVE	4
1.2 AKTET E BRENDSHME TË NDËRMARRJES	5
2. MARRËVESHJET E NDËRMARRJES ME KOMUNËN E SKENDERAJT PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE	6
3. NUMRI I PUNONJËSVE NË FUND TË MUAJIT DHJETOR	6
4. QARKULLIMI I NDËRMARRJES PËR VITIN KALENDARIK 2025	6
5. PËRFUNDIMI	7

Hyrje

Ky raport është hartuar nga Komisioni Komunal i Aksionarëve në përputhshmëri me nenin 8.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike në të cilin thuhet si në vijim: “8.2 Çdo Komision Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me këtë ligj. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6.2 të këtij 6 ligji.. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të NP-së përkatëse Lokale në interes të Komunës ose Komunave përkatëse.”

Në këtë raport janë bërë sqarimet lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Komisioni në bazë të Ligjit për Ndërmarrje Publike, dhe në të njëjtën kohë është bërë një sqarim në lidhje me numrin e të punësuarve të ndërmarrjes në fund të vitit kalendarik 2025, po ashtu në kuadër të këtij raporti kemi përfshirë pasqyrat vjetore të ndërmarrjes për vitin kalendarik 2025.

Qëllimi:

Të paraqes në mënyrë objektive se në çmasë janë realizuar objektivat e Komisionit Komunal të Aksionarëve, dhe në të njëjtën kohë të vlerësohet performanca e ndërmarrjes për vitin kalendarik 2025.

Objektivat:

- Vlerësimi i punës së ndërmarrjes në përgjithësi;

1. EMËRIMI DHE PUNA E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE

Kuvendi i Komunës së Skenderajit me datë 02.03.2022, kishte marr vendimin me të cilin kishte zgjedhur/emëruar dy (2) anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve të ndërmarrjes. Këtë vendim e kishin bazuar në nenin 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të cilin po e citoj si në vijim: *“5.2 Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal.”.*

Me datë 09.03.2022, Kryetari i Komunës duke zbatuar nenin e mësipërm kishte emëruar një anëtar nga Ekzekutivi i Komunës si Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve, të cilit edhe i besohet nga anëtarët e Komisionit, roli i Kryesuesit të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Neve gjatë kësaj periudhe kemi zbatuar dhe jemi duke zbatuar Ligjet si në vijim: Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

1.1 PUNA E BORDIT TË DREJTORËVE

Detyrat dhe Përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Statutin e N.P.L “Eko Natyra” Sh. A.

Kompensimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes, do të bëhet në pajtim me nenin 20 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Aktiviteti i Bordit të Drejtorëve për vitin kalendarik 2025, mund të shihet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 1: Puna e Bordit të Drejtorëve.

Nr.	Lloji i aktivitetit	Viti 2025
1.	Mbledhje të rregullta të mbajtura nga Bordi i Drejtorëve	13
2.	Procesverbale të miratuara nga Bordi i Drejtorëve	13
3.	Vendime nga Bordi i Drejtorëve	30
4.	Vlerësim i performancës financiare për Zyrtarin Kryesor Financiar	1
5.	Vendim për aprovimin e dorëheqjes së Kryeshefit Ekzekutiv	1

6.	Hapja e konkursit publik për Kryeshef Ekzekutiv	1
7.	Vendim për përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv	1
8.	Hapja e konkursit publik për Zyrtar Kryesor Financiar	1
9.	Vendim për përzgjedhjen e Zyrtarit Kryesor Financiar	1
10.	Rregullore të miratuara	6
11.	Raport vjetor	1
12.	Raporte tre (3) mujore	3
13.	Plan i biznesit	1
14.	Totali	73

1.2 AKTET E BRENDSHME TË NDËRMARRJES

Ndërmarrja ka vepruar në përputhshmëri me nenin 34.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ku thuhet se ndërmarrja duhet të ketë rregullore me të cilën rregullohet organizimi i brendshëm dhe puna e ndërmarrjes, meqë rast rregulloret të cilat janë miratuar dhe janë në fuqi në N.P.L “Eko Natyra” Sh. A, janë rregulloret si në vijim:

1. Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.
2. Rregullorja për Punën e Bordit të Drejtorëve.
3. Rregullorja mbi Përdorimin e Automjeteve Zyrtare.
4. Rregullorja për Marrëdhënien e Punës.
5. Rregullorja për arkivin dhe përdorimin e vulave zyrtare.

Me rastin e miratimit të Rregulloreve të lart cekura janë marr për bazë ligjet dhe Rregulloret që rrjedhin nga ligjet si në vijim:

1. Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
2. Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
3. Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111;
4. Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
5. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës;
6. Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;
7. Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë së bashku me plotësim ndryshimet;
8. Rregullorja MF-NR. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare;
9. Rregull financiare Nr. 01/2013/MF- Shpenzimi i Parasë Publike;

2. MARRËVESHJET E NDËRMARRJES ME KOMUNËN E SKENDERAJT PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE

Me datë 22.08.2025, ndërmarrja ka lidhur marrëveshje me Komunën e Skenderajt për kryerjen e shërbimeve komunale, ku në marrëveshjen e re janë përfshirë një sërë ndryshimesh në raport me marrëveshjet e kaluara.

Me anë të kësaj marrëveshje është zgjeruar fusha e ofrimit të shërbimit nga ana e ndërmarrjes, ku vetëm në fushën e mirëmbajtjes së hapësirave publike ka 27 pozicione, që nga kositja, grabimi dhe bartja e barit, e deri tek zbrazja e shportave të mbeturinave që gjenden në hapësira publike komunale.

Ndërmarrja ka zgjeruar shërbimin e saj në fushën e pastrimit të të gjitha objekteve që janë nën pronësinë e Komunës së Skenderajt, shtoi faktin se ndërmarrja vec se do të vazhdojë ofrimin e shërbimit të pastrimit dhe larje të rrugëve, ndërsa ndërmarrja nga muaji gusht ka filluar edhe me mirëmbajtjen dhe zgjerimin e ndricimit publik.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihni marrëveshjet e lidhura me komunën e Skenderajt sipas datës dhe nr. të protokollit.

Tabela nr. 2: Marrëveshjet e lidhura me Komunën e Skenderajt gjatë vitit 2025.

Nr.	Marreveshja	Nr. i protokollit	Data
1.	Marrëveshja me Komunën e Skenderajt për kryerjen e shërbimeve komunale	218/25	22.08.2025
2.	Aneks marrëveshja me Komunën e Skenderajt për kryerjen e shërbimeve komunale	390/25	05.12.2025

3. NUMRI I PUNONJËSVE NË FUND TË MUAJIT DHJETOR

Numri i të punësuarve që ka pas ndërmarrja në fund të muajit dhjetor ka qenë gjashtë (60), të angazhuar në njësi të ndryshme. Gjithsejt shpenzimet për pagat bruto duke përfshirë kontributet pensionale kanë qenë në vlerë prej 292,967.35 Euro.

Tabela nr. 3: Puna e Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Numri i të punësuarve – Dhjetor 2025	
Totali i të punësuarve	60

4. QARKULLIMI I NDËRMARRJES PËR VITIN KALENDARIK 2025

Në tabelën e mëposhtme mund të gjeni shifrat e qarkullimit të ndërmarrjes për vitin kalendarik 2025.

Tabela nr. 4: Qarkullimi i ndërmarrjes për vitin 2025.

Indikatori financiar	Viti 2024	Viti 2025	Ndryshimi/progresi
Të hyrat operative	242,230.00	313,302.00	70,072.00
Rezultati përfundimtar	6,813.00 (Humbje)	22,144.37 (Fitim)	Rikthim pozitiv
Gjithsejt pasuritë	41,241.00	76,909.00	Rritje e qëndrueshmërisë

Që nga ardhja e Kryeshefit të ri, ndërmarrja ka rritur të hyrat për afro 29%, një arritje e cila vjen si rezultat i drejtpërdrejtë i angazhimit të shtuar në faturimin e shërbimeve dhe zgjerimit të vëllimit të punës.

Konkretisht, të hyrat operative për vitin 2025 arritën në 313,302.00 €, një rritje prej 70,072.00 € krahasuar me vlerën prej 242,230.00 € në vitin 2024. Pas një humbjeje prej (6,813.00) € në vitin 2024, është arritur një fitim neto prej 22,144.37 € për vitin 2025, duke konsoliduar sigurinë financiare të kompanisë. Po ashtu, gjithsej pasuritë (asetet) janë rritur nga 41,241.00€ në 76,909.00€, duke rritur ndjeshëm qëndrueshmërinë e ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2025, vlera e llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera ka shënuar rritje, duke kapur vlerën prej 62,907.00 €, krahasuar me 19,588.00 € sa ishte në vitin 2024.

Kjo vlerë nuk reflekton mangësi në procesin tonë të inkasimit. Përkundrazi, kjo shumë prej rreth 62 mijë eurosh përfaqëson saktësisht punën e palodhshme që ndërmarrja ka kryer, për të cilën e ka faturuar Komunës së Skenderajt, por që pagesat ende nuk janë ekzekutuar në llogarinë e ndërmarrjes.

Kjo provon qartë se ndërmarrja i përmbushur detyrimet tona kontraktuale dhe planin e biznesit me efikasitet. Megjithatë, kjo vonesë në pagesa Komuna pengon drejtpërdrejt aftësinë e ndërmarrjes për të investuar në mjete.

5. PËRFUNDIMI

Për vitin 2025 pas ardhjes së Kryeshefit Ekzekutiv të ri, ndërmarrja jo vetëm që është stabilizuar, por po operon me profit, siç është vulosur dhe aprovuar tashmë nga Bordi i Drejtorëve. Ne si Komision Komunal i aksionarëve kërkojmë mbështetjen tuaj institucionale për të shtyrë përpara ekzekutimin e borxheve të mbetura nga Komuna, në mënyrë që fitimi i realizuar në letër të kthehet në mjet pune për zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjes.

1.)Per Drejtorin per Urbanizem

Drejtor a planifikoni te filloni në punimet e mbetura gjysmë tek asfaltimi i disa rrugve mbrenda fshatit si tek lagjet Gruda, e Gjamisë,Veliu,Koci te cillat janë te trasuara në zhavorë dhe te cillat janë mbetura te pakryera nga vitet nga vitet 2023/24.

2.) Per Drejtoreshen Kultur Rini dhe Sport!

Drejtoresh a planifikoni në këtë vitë në vazhdimin e manifestimit "Ditet e Mergates"e cilla ju kushtohet mergimtarve dhe në kuader te kësaj a keni planifikuar me ndonjë risi në program apo do te jet vazhdimesi e viteve te kaluara.

3.)Pyetje per Kryesususen e Kuvendit.

Kryesuse a keni në planë qe te bëni te mundur qe seancat e kuvendit komunal te mbahen live per publikun ashtu siqe veprojnë shumica e komunave në kosovë.

Si dhe a keni planifikuar në paisjen me laptopë per asambleistet te cillet nuk janë paisë!

Me Respect

Afrim Kabashi

Këshilltar komunal--NSD

Pyetje për Drejtorin e Urbanizmit

A) Duke qenë se pritet të fillojnë punimet në rrjetin e kanalizimit në Runik, a është planifikuar të rregullohet edhe kanalizimi në lagjen Dauti dhe Selmani? Banorët e kësaj lagjeje vazhdojnë të jenë pa kanalizim që nga vërshimet e vitit 2023, problem për të cilin besojmë se jeni i informuar. Kur pritet të ndërmerren hapa konkretë për zgjidhjen e kësaj çështjeje?

B) Banorët e lagjeve Hetimi, Hasani dhe Bejta në Klinë të Mesme kanë paraqitur kërkesë për ndërtimin e rreth 370 metrave kanalizim. Duke pasur parasysh se rrjeti ekzistues është ndërtuar në vitin 2019?

C) Drejtor, janë bërë më shumë se 7 muaj që rreth gjysma e ndriçimit publik në qendër të Runikut është jashtë funksionit. A pritet që ky problem të zgjidhet para ardhjese se diaspores?

2)Pyetje për Drejtoreshën e Kulturës

Drejtoreshë, a keni ndonjë informacion nga Ministria e Kulturës apo nga OJQ Hajde lidhur me projektin e Shtëpisë së Kulturës në Runik? Kur pritet të fillojnë punimet?

Me respekt,
Kushtrim Dragaj
Anëtar i Kuvendit Komunal(PDK)